FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 224

Tiranë – E martë, 22 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1018, datë 16.12.2020	Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: Detet".....	17555
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1021, datë 16.12.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.....	17593
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1024, datë 16.12.2020	Për miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për furnizimin me ujë të zonave rurale IV: Granti 2 i WBIF-së.....	17639
Urdhër i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 187, datë 18.12.2020	Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar.....	17648
Urdhër i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 188, datë 18.12.2020	Për miratimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të rishikuar.....	17653
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 15018, datë 17.12.2020	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	17654
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 203, datë 4.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e licencës për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së.....	17654
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 204, datë 4.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Rregullores për përcaktimin e kritereve për ushtrimin e aktivitetit të depozitimit të gazit natyror".....	17654

VENDIM
Nr. 1018, datë 16.12.2020

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT "STANDARDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË SHQIPËRI-TEMA: DETET"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 2, shkronja "u", dhe 16, pika 1, të ligjit nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e zëvendës-kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: Detet", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

STANDARDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË SHQIPËRI-TEMA: DETET

PËRMBAJTJA

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE
2. HYRJE
2.1 Qëllimi
2.2 Si lexohet dokumenti
2.3 Detyrimet ligjore
2.4 Fusha e veprimit
3. TEMA
3.1 Detet
3.1.1 Parathënie
3.1.2 Terma dhe përkufizime
3.1.3 Skemat e aplikimit dhe diagramet UML për temën: "Detet"
3.1.4 Katalogu i tipologjisë
3.1.4.1 Zonë detare
3.1.4.2 Deti
3.1.4.3 Zona e qarkullimit detar
3.1.4.4 Zona ndërbaticore
3.1.4.5 Shtrirje detare
3.1.4.6 Vlerat e parametrave
3.1.4.7 Bregdeti/ tokë e lagur
3.1.4.8 Vija bregdetare
3.1.4.9 Segmenti bregdetar
3.1.4.10 Shtresa detare
3.1.4.11 Zonë e sipërfaqes detare
3.1.4.12 Sipërfaqja e tabanit të detit
3.1.4.13 Izolinjë detare
3.1.4.14 Konturi detar
3.1.4.15 Vlerat e klasifikimit të zonave detare
3.1.4.16 Vlerat e mbulesës së tabanit të detit
3.1.4.17 Vlerat e klasifikimit të sipërfaqes së detit
3.1.4.18 Vlerat e qëndrueshmërisë së bregdetit
3.1.4.19 Vlerat e klasifikimit të llojit të bregdetit
3.1.4.20 Vlerat e llojeve të zonave
3.2 Metadatat
3.3 Kodi EPSG për KRGJSH-në
3.4 Cilësia e të dhënave
3.4.1 Elementet e cilësisë së të dhënave
3.4.2 Përputhja logjike – përputhja konceptuale (Logical consistency – Conceptual consistency)
3.4.3 Përputhja logjike – përputhja me domeinin (Logical consistency – Domain consistency)
3.4.4 Saktësia e pozicionimit – saktësia absolute ose e jashtme (Positional accuracy – Absolute or extrenal accuracy)
3.4.5 Përdorimi (Usability)
4. ANEKSE
4.1 Aneksi A – Katalogu i tipologjisë
4.2 Aneksi B – Kodlistat
4.2.1 Vlerat e klasifikimit të zonave detare
4.2.2 Vlerat e mbulesës së tabanit të detit
4.2.3 Vlerat e klasifikimit të sipërfaqes së detit
4.2.4 Vlera e qëndrueshmërisë së bregdetit
4.2.5 Vlerat e klasifikimit të llojeve të bregdetit
4.2.6 Vlerat e llojeve të zonave

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të të dhënave gjeohapësinore për ndërtimin e NSDI, duke u mbështetur në

direktivën INSPIRE. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) në bashkëpunim me Shërbimin Hidrografik Shqiptar (Komanda e Forcave Detare). Data e publikimit të versionit nr. 1 është Korrik 2018. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSDI_2018_ DT_v.1 ku:

ASIG – autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit

Standard – lloji i dokumentit

NSDI – qëllimi i dokumentit

201 – viti i krijimit

DT – tema për të cilën është krijuar standardi: "Detet", e cila i referohet temës "Sea Regions" në direktivën INSPIRE

v.1 – numri i versionit të standardit

2. HYRJE

2.1 Qëllimi

Ky dokument përcakton specifikimet teknike të harmonizuara konform direktivës INSPIRE për të dhënat gjeohapësinore të temës "Detet", temë e cila është përcaktuar në nenin 11, pika 2/u, të ligjit nr. 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë".

Ky dokument publikohet si standard që përcakton rregullat bazë të implementimit të NSDI[1] në Shqipëri, me qëllim përdorimin e tij nga autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, që të arrihet një kuptueshmëri unike dhe korrekte e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, për të realizuar ndërvepruе-shmërinë e tyre.

2.2 SI LEXOHET DOKUMENTI

2.2.1 STRUKTURA E DOKUMENTIT

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë:

1. Përshkrimi i standardeve: në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autori i standardeve.

2. Hyrje: në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të interpretohet më lehtë.

3. Tema: në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për secilën temë.

4. Anekse: në këtë pjesë jepen informacione shtesë shpjeguese në ndihmë të lexuesve.

- Përmbajtja e kapitullit III është strukturuar në 4 pjesë kryesore:

3.1 Përshkrimi i temës – këtu detajohen: **Diagramet UML** dhe **Katalogu i tipologjive**.

3.2 Metadata – këtu jepen specifikimet teknike për metadata-t e temës përkatëse.

3.3 Sistemi Koordinativ Referencë – këtu përcaktohet sistemi koordinativ referencë për të dhënat gjeohapësinore.

3.4 Cilësia e të dhënave – këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe matjes së tyre.

2.2.2 DIAGRAMET UML DHE KATALOGU I TIPOLOGJISË

Diagramet UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementet kryesor të specifikimeve dhe marrëdhëniet mes tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit gjeohapësinor, atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në "Katalogun e tipologjive" (Feature Catalogue). Personat të cilët kanë ekspertizë tematike, por nuk janë të familjarizuar me UML-në, mund ta kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave duke u fokusuar te Katalogu i tipologjive. Për përdoruesit e aplikacioneve, Katalogu i tipologjive mund të jetë i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhëna të nevojshme për përdorim.

Në tabelat e mëposhtme shpjegohet përmbajtja dhe mënyra e organizimit të informacionit në tabelat e të dhënave në Katalogun e tipologjive.

Tabelat nr. 1, 2, me anë të një shembulli, shpjegojnë mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e tipologjive dhe të atributeve të tyre.

Tabela nr. 3, me anë të një shembulli, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e kodlistës.

[1] NSDI – Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor

Tabela 1

Emri - Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi	Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE për tipologjinë.
Përshkrimi	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Lloji i tipologjisë	**Tipi i elementit** mund të jetë i këtyre llojeve: **«featureType»** - një element që mund të jetë real në terren apo një dukuri abstrakte **«dataType»** - një element tabelor që shërben vetëm si tabelë atributesh për t'u lidhur me një element tjetër **«enumeration»** "Kodlist» - listë e parapërgatitur vlerash ku elementi duhet të marrë vlerë. *Enumeration* nënkupton "renditje vlerash", ndërsa *Codelist* nënkupton "listë vlerash ose ndryshe kodlistë". Në dokument gjenden të shqipëruara si "Numërtimet dhe kodlistat". **«union»** - një mbulesë topologjike e dy ose më shumë grupe të dhënash gjeohapësinore, që ruan tiparet që përfshihen brenda shtrirjes gjeohapësinore të të dy grupeve të të dhënave hyrëse. **«Imported»** - të dhëna të specifikuara në tema të tjera të direktivës INSPIRE. Në dokument gjenden "Të dhëna të importuara"
Gjeometria	Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tri forma: **pikë, linjë ose poligon.** **Abstrakt** – kur elementi nuk është element real në terren, por konsiderohet vetëm si dukuri.
Shumëllojshmëria	Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi: 0..* - mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë 1..* - mund të marrë minimumi 1 vlerë ose shumë vlera 0..1 - mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme. 1 - duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë
I detyrueshëm	Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet
Rol shoqërimi	Në tabelën e lidhjeve "Rol shoqërimet" tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë, si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.

Tabela 2

ATRIBUTET
-- Emri -- Emërtimi i atributit **-- Përkufizimi --** Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE i elementeve **-- Përshkrimi --** Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin [I detyrueshëm: Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh: PO]

Tabela 3

ATRIBUTET
◆ Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh: ***Ligjor*** **-- Emri --** Emërtimi i vlerës **-- Përkufizimi --** Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE i elementeve
◆ Vlera e dytë (etj.) e listës së gatshme, p.sh.: ***Joligjor*** **-- Emri --** Emërtimi i vlerës **-- Përkufizimi --** Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE i elementeve

2.2.3 KARAKTERISTIKAT E <<VOIDABLE>> DHE SHUMËLLOJ-SHMËRIA

Stereotipi <<*voidable*>> përdoret për të përshkruar ato karakteristika të objekteve gjeohapësinore që mund të jenë ose mund të mos jenë të pranishme në grupet e të dhënave gjeohapësinore edhe pse mund të ekzistojnë në botën reale. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t'u jepet një vlerë.

Për të gjitha karakteristikat e përcaktuara për objektet gjeohapësinore duhet të paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave), ose vlera '*void*'. Një vlerë *void* nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse në grupet e të dhënave gjeohapësinore që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës *void* duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur duke përdorur një nga vlerat e listuara në kodlistën *VleraEArsyesSëPavlefshmërisë* (VoidReasonValue), e cila përmban:

E panjohur (Unknown)

-- Përkufizimi --

Vlera korrekte për këtë element gjeohapësinor nuk njihet ose është e pamatshme nga krijuesi i të dhënave.

-- Përshkrim --

Shembull: Kur "kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit" e një liqeni nuk është matur, atëherë arsyeja e pavlefshmërisë së kësaj karakteristike mund të jetë "E panjohur".

E papopulluar (Unpopulated)

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë nuk është pjesë e databazës së mirëmbajtur nga krijuesi i të dhënave. Pavarësisht kësaj kjo e dhënë mund të ekzistojë.

-- Përshkrimi --

Shembull: Kur "kuota e sipërfaqes së një trupi ujor nga niveli i detit" nuk është e përfshirë në grupin e të dhënave që përmban objektin gjeohapësinor të liqenit, atëherë vlera e kësaj karakteristike mund të jetë "E pa popululuar"

Konfidenciale (Withheld).

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë mund të ekzistojë por është konfidenciale.

Stereotipi <<voidable>> nuk jep asnjë informacion nëse ekziston një karakteristikë në botën reale. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh. nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria e përkatësisë do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh. nëse një njësi

administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria e përkatësisë do të jetë 1..*.

2.2.4 MBULIMET - COVERAGES

Funksionet e mbulimit *"Coverages"* përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni të botës reale që zhvillohet në kohë dhe /ose në hapësirë. Shembuj tipikë të tyre janë temperaturat, lartësitë, precipitimet, imazheritë etj. Një mbulim përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohor-gjeohapësinor. Domeinet tipike gjeohapësinore janë grupe pikash (p.sh. vendndodhja e sensorëve), kurbat përcaktuese (p.sh. izolinjat), rrjetet (p.sh. ortoimazheria, modelet e lartësisë) etj.

Në skemat e aplikimit të INSPIRE, funksionet e mbulimit janë përcaktuar si vetitë e llojeve të objekteve gjeohapësinore ku lloji i vlerës së kësaj karakteristike është një realizim i një prej llojeve të specifikuara në SSH EN ISO 19123:2007.

Për të përmirësuar përputhjen me standardet e mbulimit në nivelin e zbatimit (p.sh. ISO 19136 dhe OGC Shërbimi i Mbulimit në Internet) dhe për të përmirësuar harmonizimin ndërtematik për përdorimin e mbulimeve në INSPIRE, një skemë e aplikimit për llojet e mbulimit është përfshirë në Modelin Konceptues të Përgjithshëm " Generic Conceptual Model".

Kjo skemë aplikimi përmban llojet e mëposhtme të mbulimit:

RrjetiIMbulimitIKorrigjuar (rektifikuar): Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet i korrigjuar, një rrjet për të cilin ka një transformim përfundimtar midis koordinatave të rrjetit dhe koordinatave të sistemit koordinativ referencë. (shih figurën 1, majtas).

RrjetiIMbulimitReferencë: Mbulimi, domeini i të cilit përbëhet nga një rrjet referimi - një rrjet i lidhur me një transformim që mund të përdoret për të kthyer vlerat e koordinatave të rrjetit në vlera të koordinatave të referuara në një sistem referimi koordinativ (shih figurën 1, djathtas).

Aty ku është e mundur përdoren vetëm këto lloje mbulimi (ose një nëntip i tyre) në skemat e aplikimit në INSPIRE.



Figura 1 – Shembuj të një rrjeti të korrigjuar (majtas) dhe një rrjeti referues (djathtas)

2.2.5 NUMËRTIMET DHE KODLISTAT (ENUMERATION AND CODELIST)

Kodlistat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kodlistën, 'vlera të tjera' përcaktohet lloji i përmbajtjes së kodlistës, i përkufizuar specifikisht si më poshtë:

'jo' përfaqëson kodlista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuara në këtë dokument.

***'të* kufizuara'** përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë dokument dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

'të hapura' përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë dokument dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

'po' përfaqëson kodlista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave nuk duhet të zëvendësojnë apo të modifikojnë vlerat ekzistuese të përcaktuara në dokument.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kodlista me vlera ***jo*** të përmbajtura në dokument, ofruesit janë të detyruar t'i bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që dhe përdoruesit e tjerë t'i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t'i përdorin.

2.2.6 PARAQITJA E DIMENSIONIT KOHOR

Skemat e aplikimit përdorin atributin "FillimiICiklitJetësor" dhe "PërfundimiICiklitJetësor" për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi "FillimiICiklitJetësor" specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo është ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Atributi "PërfundimiICiklitJetësor" specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin "PërfundimiICiklitJetësor" nuk shkaktojnë ndryshime në atributin "FillimiICiklitJetësor".

Shënim i rëndësishëm:

Disa terma në Katalogun e tipologjive, si p.sh. FeatureType, DataType, Void, Coverages etj, nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike sipas termave të Direktivës INSPIRE.

2.3 DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të nenit 16, të ligjit nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", ASIG është përgjegjës për krijimin e standardeve për secilën nga temat e përcaktuara në ligj (neni 11), në përputhje me standardet Evropiane (Direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore për krijimin e NSDI në Shqipëri janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në Direktivën INSPIRE si dhe nga praktikat më të mira ndërkombëtare që mbështeten dhe bazohen në këtë direktivë. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave gjeohapësinore.

Standardet (rregullat e implementimit – IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

Metadata – në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadatat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (siç është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do të implementojnë këtë direktivë. (VKM nr. 1077, datë 23.12.2015)

Specifikimi i të dhënave – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa atribute bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë atribute të tjera për t'i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.4 FUSHA E VEPRIMIT

Të gjithë autoritetet publike, kompanitë private apo individët që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t'i nënshtrohen këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor si më poshtë:



Figura 2: Proceset e ciklit jetësor

Planifikimi – është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

Vlerësimi – është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

Procesimi – është procesi gjatë të cilit mblidhen dhe modifikohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhënash gati për t'u publikuar.

Shpërndarja – është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënat. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

Zbulimi – është proces i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jocilësore në të dhënat e publikuara.

Analiza – është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet me të dhënat që janë evidentuar.

Përditësimi – është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

Arkivimi – është procesi gjatë të cilit bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen arkivohen duke u bazuar në standarde lokale dhe në legjislacionin në fuqi të vendeve ku implementohet. Rezultat i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të pa aksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standardet specifike.

Shkatërrimi – është procesi gjatë të cilit të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde lokale ose në legjislacionin në fuqi.

3. TEMA

3.1 DETET

3.1.1 PARATHËNIE

Tema "*Detet"* parashikon një kornizë të përgjithshme për përshkrimin e ndarjeve, nën-ndarjeve ose bashkimin e deteve sipas vetive fizike dhe kimike (për shembull; zonat detare sipas temperaturës mesatare, ose zonat me karakteristika të ngjashme të sedimenteve). Gjithashtu, kjo temë lejon konceptin e emërtimeve të deteve (p.sh., *deti Adriatik*), vijës bregdetare (p.sh., *vija bregdetare shqiptare*) si dhe përcaktimin e bregut/vijës bregdetare në gjendje të ndryshme të baticës.

Përkufizimi: Kushtet fizike dhe/ose kimike të deteve dhe trupave ujorë të kripur, të ndarë në rajone dhe nënrajone (zona detare) me karakteristika të përbashkëta.

Përshkrimi: Një zonë detare mund të përmbajë karakteristika që janë elemente të temave të tjera të gjeoinformacionit si për shembull batimetria (tema "*Modeli dixhital i terrenit"*) dhe linjat e transportit detar (tema "Rrjetet e transportit"). Një zonë detare mund të jetë një grup të dhënash vektoriale (jo të dhëna të mbulimit[2]) që paraqet një gjeometri 2D të një zone që mbulohet nga një oqean, një det ose një trup ujor i kripur i ngjashëm. Kufijtë e kësaj zone marrin atribute të proceseve fizike ose kimike si për shembull:

- kripësia;
- qarkullimi aktual;
- kufijtë e masës tokësore;
- thellësia (shelfi detar, zonat ndërbaticore, humnerat);
- mbulesa e shtratit të detit (p.sh. rërë) ose e sipërfaqes (p.sh. akull).

Zonat detare kanë disa aspekte të përkohshme dhe variacione sezonale, të cilat ndryshojnë shtrirjen e zonës në varësi të rrymave detare (MHWS, MLWS, MHWN, MLWN[3]).

[2] Mbulimi – Coverage

[3] Shiko Terma dhe Përkufizime



Figura 3: Llojet dhe shtrirja e detit për nivele të ndryshme të baticës (përshtatur nga IHO H20)

Specifikimet e kësaj teme mund të bazohen në karakteristikat e përcaktuara nga *Organizata Hidrografike Ndërkombëtare (IHO)*, në veçanti nga standardi i IHO S-57. Këto specifikime përdoren në përgjithësi nga shtetet anëtare të BE.

Shembuj nga tema "*Detet*"

Bazuar nga sa më lart, në vijim jepen disa shembuj të elementeve gjeografik të *Zonave detare*:

"*Deti i Veriut*" (d.m.th. çdo përdorim i zakonshëm me emrin det ose oqean)

Një trup ujor me një kufi të përcaktuar, bazuar në modelet e zakonshme të qarkullimit rreth tokës dhe detit.

"*Qelizë sedimentare*"

Një trup ujor ose zona përgjatë vijës bregdetare dhe në zonën e afërt, ku lëvizja e materialit është kryesisht e pavarur, zakonisht i përdorur për menaxhimin e erozionit bregdetar.

"*Qelizë qarkullimi*"

Një trup ujor, i cili është destinacioni për të gjithë ndotësit që hyjnë në trupin e ujit, zakonisht i përdorur për menaxhimin e cilësisë së ujit bregdetar, për shembull nga Direktiva e Strukturës Ujore[4].

"*Sipërfaqja e tabanit të detit*"

Çdo zonë e detit e karakterizuar nga mbulesa e tabanit të detit ose thellësia.

Çfarë nuk përfshihet në temën "*Detet*"

Në temën "Detet" nuk përfshihen:

Çdo lloj ndarje me kufij, të cilat nuk janë të bazuara në kushtet fizike ose kimike; p.sh Kuadratet Marsden[5] të përdorura nga ICES.

Batimetria (thellësia e detit).

Tipologjitë *Oqeanik*e (tema e INSPIRE Oqeanet) si "temperatura" ose "rrymat baticore" (por analiza e një tipologjie *Oqeanike* mund të përcaktojë një *Zonë Detare,* gjithashtu *Elementet Gjeografike të Oqeanit* mund të jenë karakteristika (atribute) të një *Zone Detare).*

Zonat administrative, për shembull *Zona Ekonomike Ekskluzive.*

Raste përdorimi të temës "*Detet*"

Rastet e mëposhtme shërbejnë për të na ndihmuar të kuptojmë qëllimin e standardit me temë "*Detet*".

<u>Rast përdorimi për përcaktimin e zonës</u>

Ky rast i përdorimit të përgjithshëm ka për qëllim që një përdorues i thjeshtë të kuptojë nëse një zonë ose objekt ndodhet në mjedisin detar:

[4] Water Framework Directive – Direktiva e Strukturës Ujore

[5] Marsden Squares

"Alberti punon për Agjencinë Evropiane të Mjedisit. Ai do të donte të kuptonte se cilat *Zona të Mbrojtura* janë të vendosura në mjedisin detar. Për ta bërë këtë ai dëshiron të shohë një hartë të thjeshtë të të gjithë zonave të mbrojtura të BE-së, të mbuluara nga shtrirja e zonave detare Evropiane. Nga një kërkesë shtesë në këtë analizë, ai do të donte të kuptonte se cilat nga këto *Zona të mbrojtura* janë zhytur plotësisht dhe ato që janë të mbuluara nga uji si pjesë e ciklit baticor."

Rast përdorimi i përmbytjes

Menaxhimi i Rrezikut nga Përmbytjet u sugjerua si një rast përdorimi ndërtematik. Në këtë drejtim, TWG[6] për detet marrin në konsideratë rolin e deteve në menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet:

"Maria punon për ECWMF dhe po përgatit një vlerësim të rrezikut të Evropës për të përballuar stuhitë dhe ngjarjet bregdetare të përmbytjeve. Për të llogaritur rrezikun, ajo kërkon shkallën e nivelit më të lartë të mundshëm të ujit rreth vijës bregdetare evropiane."

Rasti i përdorimit të Direktivës së Strukturës Ujore

Ky rast përdorimi është vendosur për të qartësuar nevojën e deteve në mbështetje të Direktivës së Strukturës Ujore. Gjithashtu mund të përdoret si një rast i përgjithshëm i përdorimit të monitorimit të ndotjes:

"Migel duhet të ndërtojë një model ujëmbledhësi që fillon në det dhe lidhet me rrjetet e lumenjve. Zona detare e përcaktuar për këtë qëllim shërben si një gropë që mbledh ujërat e rrjetit të lumenjve. Migel duhet të jetë në gjendje të shohë se në cilat dete bëhet shkarkimi i ujëmbledhësit dhe çfarë mekanizmash ka në vend, për të monitoruar cilësinë e ujit në këto dete."

3.1.2 TERMA DHE PËRKUFIZIME

HAT – Niveli më i lartë astronomik i baticave *(Highest Astronomical Tide)*

ICES – Konventa Ndërkombëtare për Eksplorimin e Deteve *(International Convention for Exploration of the Seas)*

IHO – Organizata Ndërkombëtare e Hidrografisë *(International Hydrographic Organization)*

ISO – Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit *(International Organization for Standardization)*

LAT – Niveli më i ulët astronomik i zbaticave *(Lowest Astronomical Tide)*

MHW – Niveli mesatarë i ujit *(Mean High Water)*

MHWS – Niveli mesatar i baticës më të lartë në pranverë (*Mean High Water Spring)*

MLWS – Niveli mesatar i zbaticës më të ulët në pranverë (*Mean Low Water Spring)*

MHWN – Niveli mesatar i baticës më të ulët (*Mean High Water Neat)*

MLWN – Niveli mesatar i zbaticës më të ulët (*Mean Low Water Neat)*

Shërbimi Hidrografik përdorë dy nivele të ndryshme si referencë për nivelin e detit

Max Tide (Niveli maksimal i baticave) – Niveli maksimal i baticave i vëzhguar

Min Tide (Niveli maksimal i zbaticave) – Niveli minimal i zbaticave i vëzhguar

Në mënyrë skematike paraqiten termat dhe elementet kryesorë të deteve

[6] Thematic Working Group – Grupi i punës së temave



Figura 4: Elementet fizik të detit

(A) **Bregdet**

Një rrip toke me gjerësi të pacaktuar (deri në disa milje) që shtrihet nga bregu i brendshëm në drejtim të ndryshimit të parë të madh në karakteristikat e tokës që nuk janë të ndikuara nga proceset bregdetare.

(B) **Plazh (Breg)**

Zona e rërës së lirshme, zhavorrit dhe materialeve të tjera që shtrihen në tokë nga rrymat ujore të baticës deri në vijën bregdetare.

(C) **Zona pranë bregut**

Zona që shtrihet në drejtim të detit nga niveli i ujit në baticë përtej zonës së thyerjes. Kjo zonë është e pacaktuar dhe ndikohet nga rrymat e zonës pranë bregdetare.

(D) **Det i hapur**

Drejtimi drejt detit i zonës pranë bregut.

(E) **Vijë e bregdetit**

Vija që formon kufirin midis bregdetit (tokës) dhe plazhit (bregut). Ajo shënohet me fillimin e bimësisë së përhershme ose kur ka një ndryshim të dukshëm në morfologjinë (formën) e substratit ose formës së tokës, për shembull, nga një plazh relativisht i sheshtë në duna kodrinore.

(F) **Bregdet/Tokë e lagur**

Bregdet/Tokë e lagur (shoreline) - është një rrip toke i ndërmjetëm dhe në varësi të gjendjes së detit, mund të jetë i mbuluar nga uji ose jo, përkatësisht në baticë mbulohet në zbaticë nuk mbulohet nga uji.

(G) **Dunat**

Kreshta ose kodra me material të dallgëzuar, zakonisht rërë. Dunat shpesh kanë bimë që rriten në to.

(H) **Bregu i sipërm**

Zona e plazhit midis zonës para bregore dhe pjesës fundore të dunave. Kjo zonë është midis bregut dhe vijës bregdetare. Normalisht pjesa e prapme është e thatë; valët arrijnë këtë zonë vetëm gjatë stuhive.

(I) **Zonë parabregore**

Kjo pjesë e plazhit (breg) në mes të nivelit të ujit në baticën e ulët dhe kufirin e sipërm të valës në baticën e lartë (bregdeti).

(K) **Zonë thyerje**

Zona ku valët e thella të ujit prekin fundin dhe bëhen dallgë me ujë të cekët, duke ndryshuar nga valët e rrumbullakosura në valë të paqëndrueshme dhe të pjerrëta që fillojnë të thyhen.

(L) **Niveli i ujit në baticë**

Niveli më i lartë i ujit për çdo baticë në rritje.

(M) **Rrip (rrip rëre)**

Një argjinatur**ë** e rërës, zhavorrit, ose grimcave të tjera depozitohen në ujë të cekët nga valët dhe rrymat që janë paralele me bregun. Rripat e rërës mund të zhyten ose të dalin.

(N) **Niveli i ujit në zbaticë**

Niveli më i ulët i ujit në çdo zbaticë.

3.1.3 SKEMAT E APLIKIMIT DHE DIAGRAMAT UML PËR TEMËN: "DETET"

Modeli konceptual i temës "Detet" mund të konsiderohet si bashkim i elementeve të mëposhtëm:

- ZonaDetare, përfshijnë Detet, ZonatEQarkullimitDetar dhe ZonaNdërbaticore
- Bregdeti dhe VijaBregdetare
- IzolinjatDetare
- SipërfaqjaEZonësDetare (p.sh. derdhjet e naftës)
- SipërfaqjaETabanitTëDetit

<u>ZonaDetare, Detet, Zonat e Qarkullimit Detar dhe Zona Ndërbaticore</u>

Klasa primare në modelin e temës "Detet" është ZonaDetare. ZonaDetare mund të kuptohet si një sipërfaqe e detit, në veçanti një zonë që është përcaktuar kryesisht nga karakteristikat e tij fizike apo kimike.

Meqenëse gjeometria e detit ndryshon sipas gjendjeve të baticës, *ZonaDetare* mund të gjendet me gjeometri të ndryshme për të njëjtin rast. Gjeometria e një *ZoneDetare* përshkruhet nga tipi i të dhënave *ShtrirjaDetare* që shoqëron një *MultiSipërfaqe* (një ose më shumë zona të përcaktuara gjeometrikisht) me një gjendje të caktuar baticash, e cila duhet të merret nga kodlista *VleratENivelitTëUjit (kodlistë e importuar nga tema "Hidrografia").*

Një shembull i thjeshtë do të ishte një *ZonëDetare* me dy gjeometri, një për nivelin e baticave dhe një për nivelin e zbaticave. Në shumë aplikime në realitet efektet e baticës dhe zbaticës bëjnë pak ndryshim në gjeometri, megjithatë ka një numër rajonesh ku këto dallime janë shumë të rëndësishme kështu që skema e aplikimit plotëson të dy skenarët.

Një *ZonëDetare* gjithashtu mund të mbajë vlerat e parametrave që përshkruajnë vetitë fizike të *ZonësDetare.* Për shembull, një *ZonëDetare* mund të përmbajë informacion rreth *Temperaturës mesatare vjetore të sipërfaqes* së saj. Kjo duhet shtuar duke përdorur atributin *VleratEParametraveTëZonësDetare.*

ZonaDetare mund të klasifikohen sipas vlerave të kodlistës *VleratEKlasifikimitTëZonësDetare.* Për shembull një *ZonëDetare* mund të klasifikohet si grykëderdhje (ose ndonjë vlerë tjetër nga lista).

ZonaDetare është qëllimisht një tip shumë i përgjithshëm. Megjithatë ka ndarje të *ZonësDetare* në modelin e temës *"Detet"* që duhet të përdoren për qëllime specifike. Këto janë:

- *Deti*
- *ZonaEQarkullimitDetar*



Figura 4: Përmbledhja e UML për ZonaDetare

Tipologjia *Deti* duhet të përdoret sa herë që një *ZonëDetare* është identifikuar, me emrin det (ose oqean). Për shembull, Deti i Zi ose Deti i Veriut. *Deti* do të jetë element që përdoret në rastin e përgjithshëm ku përdoruesit kanë nevojë për një rajon detar për të kërkuar në brendësi ose për të parë shtrirjen e deteve në një hartë.

Kur përdoret termi *Deti*, *ShtrirjaDetare* e tij, duhet t'i referohet *NivelitTëLartëTëUjit* dhe nëse nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm për shkak të baticë-zbaticës, mund të përdoret *NiveliMesatarIDetit*.

Klasa *ZonaEQarkullimitDetar* duhet të përdoret sa herë që një *ZonëDetare*, është një zonë qarkullimi detar si një zonë përzierje ose qelizë sedimentesh. Lloji i zonës do të jepet duke përdorur atributin *LlojetEZonës*. Këto zona përfaqësojnë *ZonaDetare* që mund të jenë të dobishme për qëllimin e menaxhimit të erozionit bregdetar, monitorimit dhe raportimit të cilësisë së ujërave bregdetare.

ZonaNdërbaticore është një specialitet i llojit të bregdetit në *Hidrografi*. Mund të përdoret për të identifikuar pjesën e detit që është e ekspozuar (jo e mbuluar me ujë) gjatë një cikli normal të baticës. Këto janë zona të rëndësishme ekologjike.

Një *ZonëNdërbaticore* mund të cilësohet si pjesë e mjedisit detar që është ekspozuar (nuk mbulohet me ujë) gjatë një cikli normal të baticës dhe zbaticës; e përcaktuar si diferenca ndërmjet nivelit të lartë dhe çdo niveli të ulët të ujit. Shtrirja e përgjithshme e zonës ndërbaticore duhet të jepet duke iu referuar *NivelitTëLartëTëUjit,* të dy niveleve të ujit, ndërsa vlera e atributit të *NiveliTëUlëtTëUjit* duhet të specifikojë nivelin më të ulët të dy niveleve të ujit, që u përdor për të përcaktuar kufijtë e poshtëm të zonës ndërbaticore.

Rregullat e sakta për përcaktimin e shtrirjes së objekteve të ndryshme të *ZonaDetare* janë specifikuar në konventa, marrëveshje dhe legjislacione të ndryshme ndërkombëtare. Gjithashtu termi *Detet* mund të ketë lidhje me *Elementet Gjeografike Oqeanografike* që përshkruajnë elemente të tilla si temperatura, kripësia, rryma ose vala, të trajtuara në këtë temë, por kjo nuk është modeluar shprehimisht.

Referencat e objektit hidrik

***Bregdeti*:**

Një *Bregdet* është kufiri ku një zonë e detit takon tokën. Megjithatë, mund të ketë bregdete të ndryshme në varësi të gjendjes së baticës. Për këtë arsye, një *Bregdet* duhet të ketë një vlerë për *NivelinEUjërave* që identifikon gjendjen e baticës që përdoret për të përcaktuar bregun. Për trupat ujorë në brendësi të tokës duhet të përdoren vetëm termat nga tema "*Hidrografia*", p.sh. *KufiriUjëTokë*. Një *Bregdet* është një element specifik i *ObjekteveHidrike* dhe prandaj mund të ketë një emër gjeografik, p.sh. "niveli mesatar i ujit në bregdetin e Britanisë së Madhe".

Segmenti i bregdetit:

Lloji i objektit gjeohapësinor *Bregdeti* është ndërtuar nga shumë *SegmenteBregdetare*. Secili segment bregdeti ka një gjeometri të kurbës që përcakton një pjesë të bregut. Çdo *SegmentBregdetar* mund të klasifikohet sipas gjendjes së stabilitetit (gërryerje, qëndrueshmëri etj.) dhe llojit të bregdetit (rërë, baltë etj).

Vija Bregdetare:

Një *VijëBregdetare* është një rast specifik i *Bregdetit* kur niveli i ujit është i barabartë me MHW. (Vija bregdetare është e ngjashme me konceptin e *KufiritUjëTokë* në temën *"Hidrografia"*, por aplikohet vetëm në rastin e deteve, d.m.th. lumenjtë dhe liqenet përjashtohen). Një bregdet zakonisht do të jetë tipi i objektit gjeohapësinor që përdoret për shumicën e aplikacioneve që duhet të tregojnë një kufi të detit/tokës.



Figura 5: Përmbledhja e UML për VijatBregdetare dhe bregdetet

Konturi detar

Lloji i objekti gjeohapësinor, *KonturDetar,* është një grup izolinjash që përfaqësojnë vlerën e disa fenomeneve në një kohë të caktuar. Për shembull, do të përdoret zakonisht për të shfaqur konturet e temperaturës, konturet e valëve të klimës, ose vijat baticore. *Nuk duhet të përdoret për të dhënat batimetrike, të cilat duhet të përfaqësohen nga llojet e objekteve gjeohapësinore të përshkruara në temën "Modeli dixhital i terrenit – DTM".*

KonturiDetar nuk duhet të shtrihet përtej zonës që përfshinë tema "*Detet*". Një *KonturDetar* është i përbërë nga disa izolinja, për të cilat përdoret tipi i të dhënave *IzolinjatDetare*. Një lloj i të dhënave të *IzolinjaveDetare* përcakton gjeometrinë e një konturi për një vlerë të veçantë dhe përdoren shumë lakore për ta bërë këtë siç ilustrohet në Figurën 6.



Figura 6: Përdorimi i ilustruar i Izolinjave Detare dhe Vijave të Nivelit Detar



Figura 7: Përmbledhja e UML për Vijat e Nivelit Detar

Shtresat detare / Sipërfaqet e zonës detare

Një *ShtresëDetare* është një klasë e përgjithshme për të përshkruar sipërfaqet me interes në det, që nuk janë *ZonaDetare* siç përcaktohet në këtë temë. Janë dhënë dy përkufizime, një për sipërfaqen e detit dhe një për zonat e tabanit të detit. E para, *SipërfaqjaEZonësDetare*, përshkruan një zonë të sipërfaqes së detit që është me interes të veçantë. Për shembull, mund të mbulohet nga një vaj i shkëlqyeshëm ose me vegjetacion. Kjo zonë do të klasifikohet sipas kodlistës së *VleraveTëKlasifikimitTëSipërfaqesSëDetit*. Në mënyrë të ngjashme, *SipërfaqjaETabanitTëDetit* përshkruan një zonë të detit të klasifikuar sipas llojit të mbulimit. Duhet pasur parasysh se një *SipërfaqjaETabanitTëDetit* mund të ketë më shumë se një klasifikim, për shembull, kur ekziston rërë mbi baltë.

Një *ShtresëDetare* mund të lidhet në mënyrë hierarkike me shtresa të tjera detare nëpërmjet marrëdhënies së *NënShtresave*.



Figura 8: Përmbledhja e UML-së për shtresat detare

Konsistenca (lidhja logjike) midis grupeve të të dhënave gjeohapësinore

Ka disa kufizime që vlejnë për specializimet e ndryshme të *ZonësDeteve*. Për shembull, *Deti* është përcaktuar si një *ZonëDetare* me *MesatarenEUjraveTëLartë*, kështu që vlera e atributeve të *ShtrirjesDetare* duhet të jetë *MesatarjaEUjraveTëLartë* për *Detin*. Në të njëjtën mënyrë vija bregdetare është përcaktuar si bregdet në *MesatarenEUjraveTëLartë*.

Në përgjithësi, gjeometria e zonave detare dhe llojet përkatëse duhet të pasqyrojnë kufizimet e realitetit. Për shembull, një bregdet me nivelin e ulët të ujërave duhet të ndajë një gjeometri me një *ZonëDetare* në të njëjtin nivel. Një izolinjë detare duhet të përshtatet brenda një zone detare (ose të shumë zonave detare). Një *ShtresëDetare* (shtrati apo sipërfaqja e detit) duhet të përshtatet brenda gjeometrisë së një zone detare (p.sh. do të ishte absurde që të kishim mbulesën e tabanit të detit mbi tokë).







Figura 9: Struktura e temës "Detet"

3.1.4 KATALOGU I TIPOLOGJISË

3.1.4.1 ZONË DETARE

-- Emri --

Zonë detare

-- Përkufizimi --

Një zonë e detit e përcaktuar sipas karakteristikave fizike dhe kimike të saj. Mund të ketë gjeometri të shumta (shtrirje) për të përfaqësuar gjendje të ndryshme të baticës.

-- Përshkrimi --

Një *Zonë detare* është një lloj i *ObjektHidrografik*, siç përshkruhet në temën "*Hidrografia*". Ajo ka gjeometrinë e përshkruar nga një ose më shumë *MultiSipërfaqe*. Gjeometri të shumëfishta lejohen të mundësojnë që një zonë detare të përshkruhet sipas disa gjendjeve të ndryshme të baticës.

Specifikimet e *ZonësDetare* do të kufizojnë gjeometrinë në një gjendje të caktuar baticash ose në një sërë gjendjesh të baticës. *ZonaDetare* përfshijnë detet me emrin si "deti Baltik" dhe gjithashtu zonat e pa-emërtuara të detit që kanë karakteristika të veçanta kimike dhe fizike. *ZonaDetare* janë objekte 2D dhe nuk mbajnë asnjë informacion të qartë për thellësinë e detit. Kjo është specifikuar në temën "*Modeli dixhital i terrenit*".

-- Tipi i elementit --

FeatureType

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME
Agreguar nga «featureType» *ZonaDetare* tek «featureType» *ZonaDetare*
Gjeneralizuar nga «featureType» *ZonaDetare* tek «featureType» *ObjektiHidrik*

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME
Agreguar nga «featureType» *ZonaDetare* tek «featureType» *ZonaDetare*
Gjeneralizuar nga «featureType» *ZonaEQarkullimitDetar* tek «featureType» *ZonaDetare*
Gjeneralizuar nga «featureType» *Deti* tek «featureType» *ZonaDetare*

ATRIBUTET
InspireId : Identifikues Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Inspire Id **-- Përkufizimi --** Identifikuesi i objektit të jashtëm të objektit gjeohapësinor. **-- Përshkrimi --**

ATRIBUTET

Një identifikues i objektit të jashtëm është një identifikues unik i objektit i publikuar nga autoriteti përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme për të referuar objektin gjeohapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit gjeohapësinor, jo një identifikues i fenomenit të botës reale.

[I detyrueshëm: PO]

LlojetEZonësSëDetit : VleratEKlasifikimitTëLlojeveTëSipërfaqeveDetare
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Name --
Llojet e zonë së detit

-- Përkufizimi--
Lloji i *ZonësDetare* sipas klasifikimeve në kodlistën *VleratEKlasifikimeveTëZonaveDetare*. p.sh grykëderdhje e gjerë

[I detyrueshëm: PO]

Shtrirje : ShtrirjeDetare
Shumëllojshmëria: [1..*]

-- Emri --
Shtrirje

-- Përkufizimi --
Shkalla e *ZonësDetare* në një gjendje të caktuar baticash.

[I detyrueshëm: PO]

VleratEParametrave : BashkimiIVleraveTëParametrave
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --
Vlerat e parametrave

-- Përkufizimi --
Një vlerë e disa parametrave të caktuar në *ZonënDetare*. P.sh. Temperatura mesatare vjetore e detit është 12 gradë Celsius

-- Përshkrimi --
Një *ZonëDeti* mund t'i atribuohet me çdo numër vlerash që janë relevante për poligonin e *ZonësDetare* si një e tërë. Vëzhgime më të hollësishme, të tilla si rrjetet dhe të dhënat e pikave janë objekt i specifikimeve *Gjeografike të Oqeanografisë.*

[I detyrueshëm: PO]

FillimiICiklitJetësor : Datë-Orë
Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --
Fillimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --
Data dhe koha në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor është futur ose ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinore.

[I detyrueshëm: PO]

PërfundimiICiklitJetësor : Datë-Orë
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Përfundimi i ciklit jetësor

-- Përkufizimi --
Data dhe koha në të cilën ky version i objektit gjeohapësinor u zëvendësua ose u tërhoq nga grupi i të dhënave gjeohapësinore.

ATRIBUTET
[I detyrueshëm: JO]

LIDHJE
Lidhje (Drejtimi: Burimi -> Përcaktimi)
Burimi: (Class) *ZonaDetare* «featureType» Objektivi: *ZonaDetare* (Class) *ZonaEDetare* «featureType»

3.1.4.2 DETI

--Emri --

Deti

-- Përkufizimi --

Shtrirja (sipërfaqja) e detit në nivelin e *ujërave të larta* (*niveli i mesatar i baticave*).

-- Përshkrimi--

Një sipërfaqe e detit, e kufizuar nga toka dhe zona detare të tjera ngjitur. Kjo tipologji mund të përmbajë zona detare të shkallëve të vogla. Gjithashtu gjenden modele në shkallë të gjerë të qarkullimit, të cilat ndikohen nga kufijtë me tokën. Niveli *ujërat e arta* merret si *niveli i mesatar i baticave*. Si shembuj mund të përmendim: Deti i Veriut, deti Egje etj. (Burimi: IHO S23 Detet)

-- Tipi i elementit --

FeatureType

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME
Gjeneralizuar nga «featureType» *Deti* tek «featureType» *ZonaDetare*

ATRIBUTET
Shtrirja : ShtrirjaDetare Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Shtrirja **-- Përkufizimi --** Shtrirja sipërfaqësore e detit në *Nivelin e Mesatar të Baticave* [I detyrueshëm: PO]

LIDHJE
Lidhje (Drejtimi: Paspecifikuar)
Burimi: (Class) *ZonaDetare* «featureType» Objektivi: *Deti* (Class) *Deti* «featureType»

3.1.4.3 ZONA E QARKULLIMIT DETAR

-- Emri--

Zona e qarkullimit detar

-- Përkufizimi --

Një zonë e detit e përcaktuar nga modelet e tij të qarkullimit fizik dhe kimik.

-- Përshkrimi --

Përdoret në mënyrë tipike për menaxhimin dhe raportimin e mjedisit detar ose klasifikimin e mjedisit detar.

-- Tipi i elementit --

FeatureType

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME
⇐ Gjeneralizuar nga «featureType» *ZonaEQarkullimitDetar* tek «featureType» *ZonaDetare*

ATRIBUTET
LlojetEZonave : VleratELlojeveTëZonave Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Llojet e zonave **-- Përkufizimi --** Lloji i *ZonësSëQarkullimitDetar*, p.sh. *QelizaSedimentare* (zona e sendimentit). [I detyrueshëm: PO]
Shtrirje : ShtrirjeDetare Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Shtrirje **-- Përkufizimi --** Shtrirja e *ZonësSëQarkullimitDetar* në një gjendje të veçantë baticash. [I detyrueshëm: PO]

3.1.4.4 ZONA NDËRBATICORE

-- Emri --

Zona ndërbaticore

-- Përkufizimi --

Pjesa e mjedisit detar që është e ekspozuar (nuk është e mbuluar me ujë) gjatë një cikli normal të baticës; e përcaktuar si diferenca ndërmjet nivelit të lartë dhe çdo niveli të ulët të ujit.

-- Përshkrimi--

Pjesa e mjedisit detar që është e ekspozuar (nuk është e mbuluar me ujë) gjatë një cikli normal të baticës.

-- Tipi i elementit --

FeatureType

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME
⇐ Gjeneralizuar nga «featureType» *ZonaNdërbaticore* tek «featureType» *Bregdet*

ATRIBUTET
NiveliILartëIUjit : VleratENivelitTëUjit Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Niveli i lartë i ujit (baticës) **-- Përkufizimi--** Niveli i lartë i ujit i cili përdoret për të përcaktuar kufirin e sipërm të zonës ndërbaticore p.sh. "*Niveli Mesatar i Baticës*". [I detyrueshëm: PO]
NiveliIUlëtIUjit : VleratENivelitTëUjit Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Niveli i ulët i ujit (zbaticës)

ATRIBUTET
-- Përkufizimi -- Niveli i ulët i ujit i cili përdoret për të përcaktuar kufirin e poshtëm të ZonësNdërbaticore p.sh. *"Niveli Mesatar Zbaticës".* [I detyrueshëm: PO]

3.1.4.5 SHTRIRJE DETARE

-- Emri --

Shtrirje detare

-- Përkufizimi --

Shtrirja e një *ZoneDetare* në një gjendje të caktuar baticash.

-- Përshkrimi --

Shtrirja gjeometrike 2D e një *ZoneDetare* për një gjendje të veçantë baticash.

-- Tipi i elementit --

DataType

ATRIBUTET
Geometri : GM_MultiSipërfaqe Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --** Gjeometria **-- Përkufizimi --** Gjeometria e *ShtrirjesDetare* . **-- Përshkrimi --** Një *MultiSipërfaqe* përdoret në mënyrë që të paraqesë gjendje të ndryshme të baticës në shtete të ndryshme, e cila bën të mundur paraqitjen e zonave që herë pas here shfaqen si zona detare të izoluara nga toka, për shkak të vlerave të ndryshme të baticës. Kjo është prioritet për detet në shkallë lokale [I detyrueshëm: PO]
NiveliIUjit : VleratENivelitTëUjit Shumëllojshmëria: [0..1] **-- Emri --** Niveli i ujit **-- Përkufizimi --** Vlera e nivelit të ujit në të cilën *ShtrirjaDetare* është e vlefshme. [I detyrueshëm: PO]

3.1.4.6 VLERAT E PARAMETRAVE

-- Emri --

Vlera e parametrave

-- Përkufizimi --

Një sërë parametrash që përmbajnë një vlerë të disa karakteristikave të vëzhguara, p.sh., *temperatura mesatare vjetore e sipërfaqes së detit.*

-- Tipi i elementit --

DataType

ATRIBUTET
Parametri : KarakteristikaEVëzhgimitAbstrakt Shumëllojshmëria: [1] **-- Emri --**

ATRIBUTET
Parametri **-- Përkufizimi --** Një përkufizim i parametrit të vëzhguar (p.sh. temperatura mesatare). [I detyrueshëm: PO]
Ministri i Financave dhe Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje, që cenojnë vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 3.2), nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave dhe miratim nga qeveria apo miratime të tjera. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje, që cenojnë vetëm marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Marrësit, nuk kërkojnë miratimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

Çdo njoftim apo deklaratë e tillë konsiderohet e marrë menjëherë pasi të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në adresa të tjera të palës kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në:
KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Republika Federale e Gjermanisë
Faks: +49 69 7431-2944

Për Marrësin:
Republika e Shqipërisë
Përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
Tiranë
Shqipëri
Faks: +35542228494
Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit
Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga "Sami Frashëri", 10
Telefon: +355 4234 885
Faks: +355 4234 885

7. Shërbimet e Ekspertëve

7.1 Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) përgatit dhe livron Shërbimet e Ekspertëve në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, standardet mjedisore dhe sociale, si dhe, veçanërisht, në përputhje me konceptin e dakordësuar ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së për Shërbimet e Ekspertëve, dhe për këtë qëllim përdor shërbimet e inxhinierëve konsultues të pavarur dhe të kualifikuar;

b) përmbush kurdoherë dispozitat e prokurimit të parashikuara në Marrëveshjen e Veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

c) mban ose siguron mbajtjen e librave, regjistrave dhe llogarive të sakta dhe të rregullta, duke specifikuar në mënyrë transparente të gjitha kostot e shkaktuara në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe duke identifikuar qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky Grant financiar;

d) iu mundëson përfaqësuesve të KfW-së që të inspektojnë në çdo kohë librat dhe regjistrat, si dhe çdo dokumentacion tjetër përkatës që lidhet me livrimin e Shërbimeve të Ekspertëve;

e) i jep KfW-së brenda dy javësh nga paraqitja e kërkesës, çdo dhe të gjitha informacionet dhe dëshmitë për Shërbimet e Ekspertëve dhe progresin e tyre të mëtejshëm, sipas kërkesës së KfW-së, duke përfshirë, por pa u kufizuar tek informacionet dhe raportet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të WBIF-së për të raportuar, në veçanti: i: raportet e zbatimit vjetor në fund të shkurtit të çdo viti, të cilat përshijnë pjesën përshkruese dhe atë financiare, si dhe ii. të dhënat përkatëse për përditësimet gjashtëmujore në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të WBIF-së në fund të marsit dhe shtatorit të çdo viti;

f) merr masat e arsyeshme, në përputhje me rregulloret dhe rregullat e veta, për të siguruar se kandidatët ose tenderuesit apo aplikantët e mundshëm përjashtohen nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit dhe nga dhënia e kontratës së prokurimit të financuar nga BE-ja/WBIF-ja, nëse Agjencia e Zbatimit të Projektit merr dijeni se ndaj këtyre subjekteve:

i. ose personave me të drejta përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli mbi këto subjekte është dhënë një vendim penal ose administrativ i formës së prerë për mashtrim, korrupsion, përfshirje në organizata kriminale, pastrim parash, vepra penale të lidhura me terrorizmin, punën e detyruar të fëmijës apo trafikimin e qenieve njerëzore;

ii. ose personave me të drejta përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli mbi këto subjekte është dhënë një vendim penal ose administrativ i formës së prerë për parregullsi që cenojnë interesat financiarë të BE-së;

iii. është dhënë një vendim ku shpallen përgjegjës për keqpërfaqësim, në lidhje me ofrimin e informacionit të kërkuar si kusht për të marrë pjesë në procedurë ose nëse nuk e ofrojnë këtë informacion.

7.2 Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) sigurojnë financimin e plotë të Shërbimeve të Ekspertëve dhe, me kërkesë, i vënë në dispozicion KfW-së dëshmi që vërtetojnë mbulimin e kostove të papaguara nga ky kontribut financiar;

b) informojnë vullnetarisht KfW-në për çdo apo të gjitha rrethanat që mund të pengojnë, vonojnë, rrezikojnë apo ndikojnë negativisht në livrimin, operimin, menaxhimin ose qëllimin e Shërbimeve të Ekspertëve;

c) marrin masa të efektshme dhe proporcionale për zbutjen e rrezikut të praktikave të ndaluara ose të veprimtarive të tjera të jashtëligjshme, në lidhje me përdorimin e kontributit financiar dhe/ose livrimin e Shërbimeve të Ekspertëve. Të gjitha rastet e praktikave të ndaluara, që lidhen me kontributin financiar dhe/ose livrimin e Shërbimeve të Ekspertëve, si dhe masat e lidhura me to, të marra nga Marrësi dhe/ose Agjencia e Zbatimit të Projektit i duhen raportuar KfW-së menjëherë. Marrësi, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, merr masat për zgjidhjen e kontratave me kontraktuesit, për të cilat është përcaktuar se këta kontraktues janë përfshirë në Praktika të Ndaluara, në lidhje me livrimin e Shërbimeve të Ekspertëve dhe merr masat e duhura për rikuperimin e kontributit të keqpërdorur financiar ose të një pjese të tij.

Praktika të ndaluara nënkuptojnë një ose më shumë nga praktikat e mëposhtme:

i. praktikë kanosëse, siç përkufizohet në shtojcën 1;

ii. praktikë e fshehtë, siç përkufizohet në shtojcën 1;

iii. praktikë korruptive, siç përkufizohet në shtojcën 1;

iv. praktikë mashtruese, siç përkufizohet në shtojcën 1;

v. vjedhje që nënkupton përvetësimin e një prone që i përket një pale tjetër;

d) u mundësojnë Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve apo çdo përfaqësuesi të autorizuar të shqyrtojë dokumentacionin dhe të kryejë kontrolle pa paralajmërim për përdorimin e kontributit financiar (duke përfshirë edhe procedurat e dhënies së kontratave të financuara nga kontributi financiar), në bazë të dokumenteve mbështetëse të kontabilitetit dhe çdo dokumenti tjetër të lidhur me financimin e Shërbimeve të Ekspertëve;

e) i mundësojnë Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (referuar në vijim si "OLAF") të kryejë hetime, duke përfshirë edhe kontrolle pa paralajmërim, në përputhje me dispozitat e parashikuara në legjislacionin e BE-së për mbrojtjen e interesave financiarë të BE-së ndaj mashtrimit, korrupsionit dhe çdo veprimtarie tjetër të paligjshme, dhe kur është e zbatueshme, çdo marrëveshje të bashkëpunimit administrativ të

lidhur ndërmjet OLAF-it dhe organeve kundër mashtrimit të KfW-së;

f) ndërmarrin t'u ofrojnë zyrtarëve të Komisionit Evropian, OLAF-it, Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe agjentëve të tyre të autorizuar, me kërkesë, informacion dhe akses në çdo dokument dhe të dhëna të kompjuterizuara në lidhje me menaxhimin teknik dhe financiar të operacioneve të financuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe t'u japë akses në mjediset dhe vendet ku kryhen këto operacione. Dokumentet dhe të dhënat e kompjuterizuara mund të përfshijnë informacione që Marrësi dhe/ose Agjencia e Zbatimit të Projektit i konsiderojnë konfidenciale, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e veta të përcaktuara ose siç rregullohet nga marrëveshja kontraktuese. Sapo t'i ofrohet Komisionit Evropian, OLAF-it, Gjykatës Evropiane të Audituesve apo çdo përfaqësuesi tjetër të autorizuar, ky lloj informacioni trajtohet në përputhje me rregullat dhe legjislacionin e konfidencialitetit të BE-së. Dokumentet duhet të jenë të aksesueshme dhe të ruajtura, në mënyrë që të mundësojnë kontrollet. Marrësi dhe/ose Agjencia e Zbatimit të Projektit kanë detyrimin të informojnë Komisionin Evropian, OLAF-in ose Gjykatën Evropiane të Audituesve për vendndodhjen e saktë të ruajtjes. Kur çmohet e përshtatshme, palët mund të bien dakord të dërgojnë kopje të këtyre dokumenteve për shqyrtim dokumentacioni; dhe

g) informojnë Komisionin Evropian nëse, në lidhje me livrimin e Shërbimeve të Ekspertëve, ndonjë prej tyre ka konstatuar se një palë e tretë është përfshirë në një prej situatave të referuara më poshtë ose, nëse ka zbuluar ndonjë mashtrim dhe/ose parregullsi. Komisioni Evropian e regjistron këtë informacion në Sistemin e Gjurmimit dhe Përjashtimit të Hershëm. Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit e informojnë Komisionin Evropian nëse ndonjë prej tyre merr dijeni se informacioni i përcjellë duhet korrigjuar, përditësuar apo hequr. Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit sigurohen se subjekti i interesuar është informuar se të dhënat e tij po i përcillen Komisionit Evropian dhe mund të regjistrohen në Sistemin e Gjurmimit dhe Përjashtimit të Hershëm dhe të publikohen në faqen e internetit të Komisionit Evropian.

h) sigurojnë edhe zbatimin e udhëzimeve të komunikimit dhe të vizibilitetit të WBIF-së, bashkëlidhur Marrëveshjes së Veçantë si shtojcë, të referuar në nenin 7.3.

7.3 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë përkatëse të neneve 7.1 dhe 7.2 nëpërmjet Marrëveshjes së Veçantë, e cila kundërfirmoset/siglohet nga Marrësi i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

7.4 Marrësi e ndihmon Agjencinë e Zbatimit të Projektit, në përputhje me praktikat e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në livrimin e Shërbimeve të Ekspertëve dhe përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, i japin Agjencisë së Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për livrimin e Shërbimeve të Ekspertëve.

7.5 Gjatë dhënies së kontratës, Marrësi dhe/ose Agjencia e Zbatimit të Projektit, mund të marrin parasysh, siç çmohet e përshtatshme dhe nën përgjegjësinë e tyre të plotë, informacionin që ndodhet në Sistemin e Gjurmimit dhe Përjashtimit të Hershëm. Aksesi në informacion mund të ofrohet nëpërmjet personave të autorizuar ose konsultimit me Komisionin Evropian.

8. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me shërbimet e ekspertëve

8.1 Për të përmbushur parimet e pranuara në nivel ndërkombëtar për arritjen e transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja e bën publik informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit *ex post)* për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjeve të lidhura me programin e shërbimeve të ekspertëve dhe me fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si "Periudha e Plotë").

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për fushën e tij të biznesit "Banka e Zhvillimit KfW" (http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/).

Publikimi i informacionit (qoftë nga KfW-ja apo palët e treta, në përputhje me nenin 8.3 më poshtë) për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të

hollësishëm sensitiv financiar apo të lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në Shërbimet e Ekspertëve ose në financimin e tyre, si:

a) informacion për të dhënat e brendshme financiare;

b) strategjitë e biznesit;

c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;

d) të dhëna personale për personat fizikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

8.2 KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

a) filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;*

d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) palët e Kushteve të Përgjithshme të EWBJF-së;

f) institucionet administruese të EWBJF-së;

g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij.

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, të cilat botojnë seksionet që kanë lidhje me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Nismës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare (http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/wege/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);

b) Tregu dhe Investimi Gjerman (GTAI), për qëllimet e informacionit për tregun (http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO);

c) OECD-ja për qëllimet e raportimit të flukseve financiare, në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (http://stats.oecd.org/);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval), për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim, për të garantuar transparencë dhe efikasitet (http://www.deval.org/de/);

e) palët e Kushteve të Përgjithshme të EWBJF-së;

f) institucionet administruese të EWBJF-së;

g) Bashkimi Evropian dhe institucionet e tij.

8.4 KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën e tyre të financimit gjatë periudhës së plotë te palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta, nëse interesat e ligjshëm të Marrësit dhe/ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit në informacionin që nuk transferohet i tejkalon interesat e KFW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Marrësit dhe/ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit përfshijnë, veçanërisht, konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 8.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtën t'u transferojë informacion palëve të treta, nëse kjo është e nevojshme, për shkak të kërkesave statutore ose rregullatore ose për të ruajtur dhe për të mbrojtur pretendimet dhe të drejtat e tjera ligjore në proceset gjyqësore ose administrative.

9. Dispozita të ndryshme

9.1 Marrësi ndërmerr të përmbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën 1a (Akti i përputhshmërisë së përfituesit). Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të përmbushë në çdo kohë detyrimet e parashtruara në shtojcën 1b (Akti i përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit).

9.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej saj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit mund të mos caktojnë ose transferojnë, zotojnë ose hipotekojnë asnjë pretendim nga kjo Marrëveshje.

9.4 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main.

9.5 Marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Marrësit, të përcaktuara në këtë Marrëveshje, përfundojnë gjashtë vjet pas disbursimit të fundit.

9.6 Kjo Marrëveshje Financimi nuk hyn në fuqi dhe nuk ka efekt derisa Marrësi të informojë KfW-në me shkrim, se procedurat që duhen kryer nga ai personalisht, kanë përfunduar.

E hartuar në tri kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,
sot më ditën e 29 të tetorit 2020

KfW

_____nënshkrimi_____

Emri: Bjoern Thies
Pozicioni: Drejtori KfW-së Tiranë

_____nënshkrimi_____

Emri: Christina Kern
Pozicioni: Menaxhere Projekti

Tiranë,
sot më ditën e 27 të tetorit 2020

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

_____nënshkrimi_____

Emri: Anila Denaj
Pozicioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

_____nënshkrimi_____

Emri: Dritan Agolli
Pozicioni: Drejtor Ekzekutiv

Shtojca:

- 1a – Akti i përputhshmërisë së Përfituesit;
- 1b – Akti i përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

SHTOJCA 1a
AKTET E PËRPUTHSHMËRISË SË PËRFITUESIT

1. PËRKUFIZIME

"Praktikë kanosëse", dëmtimi apo lëndimi ose kërcënimi për dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë një personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e atij personi.

"Praktikë e fshehtë" është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

"Praktikë korruptive", premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, e ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

"Praktikë mashtruese" është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose përpiqet të çorientojë, qoftë me ose pa dashje, një person me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose të shmangies së një detyrimi.

"Praktikë penguese": i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore ose dhënia e dëshmive të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi akuzën e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike kanosëse, praktike të fshehtë ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka di për çështjen që lidhet me hetimin ose të kryejë hetimin; apo ii. çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht lidhur me një hetim zyrtar mbi akuzat e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike kanosëse ose praktike të fshehtë.

"Person", një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

"Praktikë e sanksionueshme", çdo praktikë kanosëse, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktike mashtruese, ose praktike penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i: është e paligjshme, sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose të lidhur me reputacionin mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Përfituesit dhe KfW-së apo zbatimi të saj.

"Sanksionet", sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga organi sanksionues.

"Organ sanksionues", Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.

"Listë e Sanksioneve", çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë

specifike që u nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga çdo organ sanksionues.

2. NDËRMARRJET LIDHUR ME INFORMACIONIN

Marrësi:

a) i vë në dispozicion KfW-së në kohë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me njohjen e klientit apo informacione të ngjashme për Marrësin;

b) i ofron KfW-së, sipas kërkesës, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, të gjithë informacionin dhe dokumentet mbi Shërbimet e Ekspertëve të Përfituesit dhe palëve të tij (nën)kontraktuale apo palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimin e parave, dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së punës me Marrësin që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në në kohë dhe me nismën e tij, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Shërbimet e Ekspertëve;

d) i jep KfW-së, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) u mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj, përmes Agjencisë së Zbatimit të Projektit, inspektimin në çdo kohë të dokumentacionit të Marrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktuale apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe kryerjen e vizitave për Shërbimet e Ekspertëve dhe të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman apo legjislacionit të vendit të Marrësit, Marrësi garanton se asnjë prej personave që vepron në emër të Marrësit për Shërbimet e Ekspertëve nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

3.2 Sigurimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje të Grantit, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. NDËRMARRJET POZITIVE

Marrësi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, sapo Marrësi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim të terrorizmit, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Në veçanti, Marrësi i përgjigjet në kohë dhe hollësisht çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. NDËRMARRJET NEGATIVE

Marrësi nuk kryen transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me Shërbimet e Ekspertëve që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

SHTOJCA 1b
AKTET E PËRPUTHSHMËRISË SË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË PROJEKTIT

1. PËRKUFIZIME

"Praktikë kanosëse", dëmtimi apo lëndimi ose kërcënimi për dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e atij personi.

"Praktikë e fshehtë" është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

"Praktikë korruptive", premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

"Kategoritë e përcaktuara të shkeljeve", kategoritë e mëposhtme të shkeljeve, të përcaktuara sipas rekomandimeve të FATF-së dhe shënimeve përkatëse interpretuese: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe shantazhim; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i emigrantëve; shfrytëzimi seksual, duke përfshirë

shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe i substancave psikotrope; trafikimi i paligjshëm i armëve; trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhura dhe i mallrave të tjera; korrupsioni dhe mitmarrja/mitdhënia; mashtrimi; falsifikimi i parave; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja, lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi; mbajtja me forcë dhe pengmarrja; grabitja dhe vjedhja; kontrabandimi (duke përfshirë edhe në lidhje me taksat e tarifat doganore dhe akcizat); krimet tatimore (lidhur me taksat direkte dhe indirekte); zhvatja; falsifikimi, pirateria; manipulimi i tregut dhe tregtimi i brendshëm.

"Rekomandimet e FATF-së", këto rekomandime, siç përcaktohen herë pas here nga Grupi i Posaçëm për Veprimin Financiar (FATF). FATF-ja është një organ ndërqeveritar, qëllimi i të cilit është zhvillimi dhe promovimi i politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

"Praktikë mashtruese" është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë keqpërfaqësimin që çorienton ose përpiqet të çorientojë, qoftë me ose pa dashje një person, me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi.

"Burim i paligjshëm", burimi i fondeve të siguruara përmes:

a) shkeljeve të renditura në kategorinë e përcaktuar të shkeljeve;

b) çdo praktikë korruptive;

c) çdo praktikë mashtruese; ose

d) pastrimi i parave.

"Praktikë penguese": i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore, ose dhënia e dëshmive të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi akuzën e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike kanosëse, praktike të fshehtë ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka di për çështjen që lidhet me hetimin, ose nga kryerja e hetimit; ose ii. çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht, lidhur me një hetim zyrtar mbi akuzat e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike kanosëse ose praktike të fshehtë.

"Person", një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

"Praktikë e sanksionueshme", çdo praktikë kanosëse, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktikë mashtruese ose praktikë penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose të lidhur me reputacionin mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Marrësit dhe KfW-së, apo zbatimi të saj.

"Organ sanksionues", Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.

"Sanksionet", sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga organi sanksionues.

"Lista e sanksioneve", çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike, që u nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga çdo organ sanksionues.

2. NDËRMARRJET LIDHUR ME INFORMACIONIN

Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) i vë në dispozicion KfW-së në kohë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me njohjen e klientit apo informacione të ngjashme për Agjencinë e Zbatimit të Projektit dhe aksionarëve (të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë), filialeve dhe/ose ortakëve të tjerë të saj (nëse ka);

b) i ofron KfW-së në kohë, sipas kërkesës, nëpërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit, të gjithë informacionin dhe dokumentet mbi Shërbimet e Ekspertëve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese apo palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së punës me Agjencinë e Zbatimit të Projektit që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në në kohë dhe me nismën e saj, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, anëtarët e organeve të saj të

menaxhimit, organeve të tjera qeverisëse apo aksionarëve të saj;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce;

e) i mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj inspektimin në çdo kohë të dokumentacionit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të mbi Shërbimet e Ekspertëve dhe kryerjen e vizitave për Shërbimet e Ekspertëve dhe të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

f) informon KfW-në në kohë dhe me nismën e saj për çdo rast, që mund të sjellë klasifikimin ekzistues ose të mundshëm të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, anëtarëve të organeve të saj të menaxhimit ose organeve të tjera qeverisëse apo të aksionarëve të saj, si shtetas me emërtim të veçantë, ose personave apo subjekteve të bllokuara, të renditur në çdo lloj liste sanksionesh.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1 Për sa i përket legjislacionit gjerman ose të vendit të Marrësit për ngritjen e Agjencisë së Zbatimit të Projektit, kjo e fundit siguron dhe garanton se janë të vërteta dhe të sakta sa më poshtë:

a) në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari vet;

b) në dijeni të saj dhe vetëm në lidhje me aksionarët që njihen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, sipas rregulloreve të zbatueshme të bursës, as kapitali i Agjencisë së Zbatimit të Projektit, as fondet e investuara në Shërbimet e Ekspertëve nuk kanë Burim të Paligjshëm.

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit, ortakët, filialet apo asnjë person tjetër që vepron në emër të saj nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim të terrorizmit.

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk: i. ka lidhur ndonjë marrëdhënie pune me shtetas me emërtim të veçantë apo persona dhe subjekte të bllokuara, të renditur në çfarëdo lloj liste sanksionesh; ose nuk ii. është angazhuar në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

3.2 Sigurimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje të Grantit, duke iu referuar rrethanave mbizëtoruese në atë datë.

4. NDËRMARRJET POZITIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) përmbushë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e FATF-së dhe të zbatojë, respektojë dhe përmirësojë, nëse është e nevojshme, standardet dhe udhëzimet e brendshme (duke përfshirë pa asnjë kufizim, kujdesin ndaj klientit), të nevojshme për shmangien e praktikave të sanksionueshme, akteve të pastrimit të parave ose financimin e terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim terrorizmi, të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Agjencia e Zbatimit të Projektit i përgjigjet në kohë dhe hollësisht çdo njoftimi të KfW-së, në veçanti, dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. NDËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) sigurojë se kapitali apo fondet e tjera që investon nuk kanë Burim të Paligjshëm;

b) sigurojë se proceset e saj të punës nuk lënë vend për praktika të sanksionueshme, pastrim parash apo financim të terrorizmit; dhe

c) të mos lidhë apo të mos vijojë asnjë marrëdhënie pune me shtetas me emërtim të veçantë, persona ose subjekte të bllokuara, të renditur në ndonjë listë sanksionesh ose të mos angazhohet në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

URDHËR
Nr. 187, datë 18.12.2020

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË RISHIKUAR

Në mbështetje të germës "c", të nenit 4, neneve 5 dhe 6, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit",

URDHËROJ

1. Miratimin e "Programit të Transparencës të Rishikuar", sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri të gjitha autoritetet publike, me përjashtim të njësive të vetëqeverisjes vendore.

3. Autoritetet publike, të përcaktuara në pikën 2 më sipër, zbatojnë programin institucional të transparencës të rishikuar, sipas formës dhe përmbajtjes në përputhje me lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri, jo më vonë se data 31 mars 2021.

4. Pika 1, e urdhrit nr. 14, datë 22.1.2015 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONER
Besnik Dervishi

Lidhja nr. 1




Rreth autoritetit
Struktura organizative/Organigrama
Struktura e pagave
Funksionet dhe detyrat e A.P
CV-të dhe pagat e nëpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të Ministrit të AP, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre
Procedura në ndjekje funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime
Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e AP (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve)
Kuadri ligjor rregullator
Tekset e plota
Legjislacion ndërkombëtar
Legjislacion kombëtar
Akte nënligjore
Rregullore
Kodi i sjelljes
Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe brive themelore të individit
Strategji
Raport vjetor
Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e AP dhe që prek publikun
E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar
Koordinatori/Emri mbiemri
E-mail
Nr. I gjelbër
Tel
Adresa
Orari
Format kërkese / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)
Format ankese / Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisioneri)
Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP
Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë (nëse ka të tillë)
Planet strategjike të punës
Raporte monitorimi/auditimi (p.sh.KLSH)
Dokumente të tjera që përmbajnë treguesit e performancës së AP

- Buxhet; plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara
- Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset
- Donacione, sponsorizime
- Dokumente që bëjnë pjesë në shtyllën e shërbimeve nga subjektet e licencuara

Shënim: Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij bëhen publike edhe dokumentet që bëjnë pjesë në shtyllën e shërbimeve nga subjektet e licencuara

- Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve)
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik
- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik
- Informacion mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme

Lista e Shërbimeve* që ofron AP përfshirë

- tarifat përkatëse (nëse ka)
- formular aplikimi
- afati kohor
- procedura ankimimi
- standardet për cilësinë e shërbimit

Shënim: Lëshim dokumentacion/Leje/Licenca/Autorizime etje


Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP
• Njoftimi dhe konsultimi publik (1 muaj)
• Komente/Rekomandime/Opinione të palëve të interesuara/grupe interesi
• Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve
• Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes
• Procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP
• Emër mbiemër të koordinatorit për konsultimin publik, adresë postare/elektronike
Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve
• Lista e dokumenteve që administrohen nga AP me afatet e ruajtjes
• Formati e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve
• Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar (sipas Modelit të Regjistrit të miratuar nga Komisioneri)
Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP
• Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP
• Kategoritë dhe formati e ndihmës shoqërore/subvencioneve
• Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim
• Procedura e ankimimit
• Kërkesat dhe përgjigjet (të linkuara por AP që nuk kanë instaluar portalin Pyet Shtetin/Portali Pyet Shtetin i përditësuar me kërkesat dhe përgjigjet



URDHËR
Nr. 188, datë 18.12.2020

PËR MIRATIMIN E REGJISTRIT TË KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE TË RISHIKUAR

Në mbështetje të nenit 8, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, të rishikuar në format dhe përmbajtje, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen të gjitha autoritetet publike të zbatojnë Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të rishikuar sipas formatit dhe përmbajtjes, të përcaktuar në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri, jo më vonë se data 31 mars 2021.

3. Pika 2, e urdhrit nr. 14, datë 22.1.2015 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës", të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

Lidhja nr. 1

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. rendor[10]	Data e kërkesës[11]	Objekti i kërkesës[12]	Data e përgjigjes[13]	Përgjigje [14]	Mënyra e përfundimit të kërkesës[15]	Tarifa [16]

[10] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.
[11] Data e regjistrimit të kërkesës.
[12] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
[13] Data e kthimit të përgjigjes.
[14] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
[15] Përgjigja jepet e plotë/ e kufizuar/ e refuzuar/ e deleguar.
[16] Kostoja monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

NJOFTIM
Nr. 15018, datë 17.12.2020

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, nënshkruar më 3.5.2016, ka hyrë në fuqi më 21 shkurt 2020.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM
Nr. 203, datë 4.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË IMPIANTET E GNL-së

Në mbështetje të nenit 16, pika 11, nenit 22, nenit 23, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, si dhe nenit 26 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 127/2 prot., datë 2.12.2020, të Drejtorive Teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e licencës për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së,

konstatoi se:

- ERE ka hartuar draft-licencën dhe kushtet e saj për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së, duke përcaktuar kushtet, afatet apo të drejtat e detyrimet e të licencuarit mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.

- Draft-licenca, me kushtet e saj për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së, saktëson spektrin e të drejtave dhe detyrimeve për çdo subjekt që licencohet në ushtrimin e këtij aktiviteti.

- Draft licenca saktëson tërësinë e të drejtave të ERE-s në raport me të licencuarin, në mbështetje të ligjit nr. 102/2010, "Për sektorin e gazit natyror", si dhe legjislacionit të miratuar në zbatim të tij.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e licencës për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së.

2. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 204, datë 4.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E "RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 16, nenit 29, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 127/3 prot., datë 2.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Rregullores për përcaktimin e kritereve për ushtrimin e aktivitetit të depozitimit të gazit natyror",

konstatoi se:

- Drejtoritë Teknike kanë draftuar "Rregulloren për depozitimin e gazit natyror", për t'u siguruar palëve të interesuara të industrisë së gazit, aktin rregullator që përcakton kriteret për ushtrimin e aktivitetit nga të licencuarit në sektorin e gazit natyror.

- Ky dokument do të sigurojë një pasqyrë më të qartë të modaliteteve të ushtrimit të këtij aktiviteti, veçanërisht për vend-depozitimin e gazit në depozitimet kripore (Diapiret e dumresë), në vendburimet e shteruara të naftës (vendburimet: Cakran–Mollaj, Ballsh–Hekal, Visokë, Patos, Gorisht–Kocul, Marinëz), dhe vendburimet e gazit (Divjakë, Frakull, Povelçë, Ballaj–Kryevidh, Panaja, Finiq–Kranë), në shtresat ujore (*Aquifaire*) atje ku mund të identifikohen, në Republikën e Shqipërisë.

- Kjo rregullore paraqet kriteret që ERE planifikon të përdorë kur merret parasysh regjimi më i përshtatshëm i aksesit të palëve të treta ose përjashtimi për depozitimin e gazit në Shqipëri në të ardhmen.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e "Rregullores për përcaktimin e kritereve për ushtrimin e aktivitetit të depozitimit të gazit natyror".

2. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2020 - Numri: 224
Datë: 2020/12/22 14:20:35
08a77d24-cf39-40c0-9127-5f069ada8562

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 416 lekë